

PROJEKTE KOMBETARE 2025

UT-KEI--Trasformimi i mësimëdhënies në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm. Politikat dhe Strategjitë e formimit universitar fillestar dhe të vazhduar të mësuesve. Problematikat aktuale dhe propozime vizionare mbi profesionin e mësuesit.

Skedë Informative e Projektit

Drejtues i projektit:

Prof. Dr. Esmeralda Kromidha

Grupi i punës:

Dr. Drita Rira, Prof. Asoc. Dr. Etleva Kondi , Prof .Dr. Dhurata Shehri , Dr. Albana Kosovrasti , Prof. Asoc. Dr. Çlirim Duro , Prof.. Dr. Edmond Rapti , Prof. Asoc. Dr. Eglantina (Xhaja) Kalluçi , Prof. Asoc. Dr. Rudina Osmanaj, Prof. Asoc. Dr. Blerina Hamzallari

Financuesi:

UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion

Periudha e zbatimit:

Mars 2025-Mars 2026

Objektivat:

- Identifikimi i arritjeve dhe nevojave për përmirësim në kuadrin ligjor dhe rregullator që rregullon formimin e mësuesve.
- Vlerësim i efektivitetit të programeve universitare të formimit të mësuesve.
- Analiza dhe vlerësimi i edukimit të vazhdueshëm dhe i sistemeve të licensimit, duke eksploruar kriteret, proceset dhe ndikimin e tyre në profesionin e mësuesit.
- Sintetizim i gjetjeve në një pasqyrim gjithëpërfshirës mbi hapat e formimit fillestar dhe të vazhduar të mësuesve.
- Evidentim i shtyllave ku duhet të mbështetet formimi fillestar dhe ai i vazhduar i mësuesve në përputhje me sfidat, zhvillimin teknologjik, qasjet pedagogjike gjithëpërfshirëse dhe të integruara si dhe ndryshimet arsimore globale.

Aktiviteti nr 1

Sot, më datë 27 Mars 2025, në sallën Rozafa pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, në kuadër të programit "UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion", u mbajt takimi i parë i projektit me titull "Transformimi i mësimdhënies në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm. Politikat dhe strategjitë e formimit universitar fillestar dhe të vazhduar të mësuesve. Problematikat aktuale dhe propozimet vizionare mbi profesionin e mësuesit."

Gjatë këtij takimi u diskutua mbi çështjet kërkimore dhe metodologjinë që do të ndiqet për të dhënë rekomandimet e duhura lidhur me profesionin e mësuesisë si dhe me politikat dhe strategjitë e formimit universitar fillestar dhe të vazhduar.

Ky aktivitet ka hapur mundësitë për një bashkëpunim më të ngushtë dhe për një analizë më të thellë të çështjeve që lidhen me zhvillimin e mësuesisë dhe sistemin arsimor.

On March 27, 2025, in the Rozafa Hall at the Faculty of Foreign Languages, within the framework of the "UT-Research, Excellence, and Innovation" program, the first meeting of the project titled "Transforming Teaching for Sustainable Development: Policies and Strategies for Initial and Continuous University-Level Teacher Training. Current Challenges and Visionary Proposals for the Teaching Profession" was held.

During this meeting, discussions focused on research topics and the methodology to be followed in order to provide appropriate recommendations concerning the teaching profession, as well as policies and strategies for initial and continuous university-level teacher training.

This event has opened opportunities for closer collaboration and a more in-depth analysis of issues related to the development of the teaching profession and the education system.

LINK <https://www.facebook.com/share/p/1621udinK4/?mibextid=ëëXlfr>

Aktiviteti nr 2

Takimi i dytë i projektit

"Transformimi i mësimdhënies në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm. Politikat dhe strategjitë e formimit universitar fillestar dhe të vazhduar të mësuesve. Problematikat aktuale dhe propozime vizionare mbi profesionin e mësuesit."

u zhvillua më 3 qershor 2025 në format hibrid — fizikisht në sallën "Rozafa" në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe online.

Gjatë takimit u diskutuan në detaje objektivat e projektit, ndërsa pjesëmarrësit ndanë ide dhe propozime për përmirësimin e qasjeve dhe forcimin e hapave të ardhshëm.

 Falënderojmë të gjithë pjesëmarrësit për angazhimin dhe kontributin e tyre të çmuar!

#TransformimiIMësimdhënies #ZhvillimIQëndrueshëm #Edukim #Inovacion #Bashkëpunim